

VENDLINDJA VLERË MBI VLERAT NDAJ AJO ËSHTË VETËM “NJË”

Ilia S. LARTI

Përmbledhje

Atdhedashuria është një ndjenjë e pastër shpirtërore që gjendet thellë në natyrën e çdo njeriu. Vendi ku lind ai, ku hap sytë, loz me dheun e tij, rritet nga ushqimet që nxjerr ai dhë, kalon stinët e jetës bashkë me ato të vendit, për të ai bëhet si nënë dhe natyrisht, dashuria ndaj tij shkrihet në gjakun e tij. Nëse atdhedashuria shfaqet në formën e duhur të njeriu, ajo mund të kultivojë tek ai vlera e virtyte të larta, e të kontribuojë për mbarësinë, jo vetëm të kombit, por të gjithë njerëzimit. Por, a lind vetvetiu dashuria ndaj atdheut në natyrën e njeriut apo i paraprin asaj diçka?! Çfarë është atdheu për dikë?, dhe, çka është ajo që i bën njerëzit ta duan atdheun? Atdheu, në radhë të parë, është pasuri, pasuri që duhet ruajtur. E ajo pasuri është e gjithanshme: familje, gjuhë, veshje, kulturë, etj. Që të gjitha këto formojnë vlerë, e cila lind një dashuri të natyrshme ndaj atdheut. Kush më pak e kush më shumë orientohet nga resuset që e mbushin zemrën e tij për dashuri e besnikëri ndaj atdheut.

Vendlindja është vendi ku njeriu lind rritet, vendi ku njeriu në ecurinë e jetës tij merr mësimet e fëmirisë, ku jeton çdo çast sa me gëzime por edhe me hidherimet. Në vendlidje, njeriu nis jetën aktive duke hedhur hapin e parë dhe nis rrugën e jetesës. Vendlindja është toka e shenjtë, ku çdo pjesë e saj i kujton njeriut origjinën e tij. Vendlindja ime Korça rri e veshur është veshur me të katër ngjyrat sipas stinëve, si e gjelbëra që mbizotëron në pranverë dhe verë, në vjeshtë verdhon dhe në dimër bardhon. Lulet janë të pranishme dhe pushtojnë çdo pjesë të qytetit tim të lulëzuar është bukur t'i shohësh. Malet përcjellin pastërëtinë e tyre në maksimum. Me një fjalë çdo gjë është e hijshme madje dhe e magjishme, pra çdo pjesë e vendlindjes time është e bukur e shëndetëshme që të jep gëzim e optimizëm.

Fjalët kyçe: atdhe, vendlindje, komb, rilindja kombëtare.

Synimi: Nëpërmjet materialit të kësaj kumtese do të synoj të përcjell sa më realisht konceptualitetet për atdheun, vendlindjen dhe çfarë shprehin ato për njerëzit që i duan dhe janë të lidhur me to, shpirtërisht dhe moralisht, nëpërmjet kontributeve për të nxjerr në pah e mbrojtur vlerat e tyre.

Nëpërmjet çështjeve kryesore do të arrihet që pjesmarrësit dhe më gjerë të thellojnë edhe më tej njohurit dhe vlerësimin për atdheun, kombin dhe vendlindjen nëpërmjet çështjeve kryesore si:

1. Njohja edhe më mirë konceptualitetit për Atdheun.
2. Përjetimi sa më qartazi i vendlindjes.
3. Sjella së afëmi e disa momente nga vendlindja ime, Korça.
4. Përmbledhje, Rekomandime.

Hyrje

Vendi im, dashuria ime më e madhe

Gjëja më e shtrenjtë! Vendi ku u lindëm e u rritëm, ku morëm mësimet e fëmijërisë, ku jetuam gëzimet dhe hidhërimet tona. Aty u formuam, hodhëm hapat e parë dhe nisëm rrugën e jetës... Vendlindja është toka, janë malet, shkëmbinjtë, fushat, lumenjtë, pemët, lulet, që në çdo moment na kujtojnë origjinën tonë. Trimëria dhe Lavdia e të parëve tanë, për t'i mbrojtur dhe lartësuar, nëpërmjet zhvillimeve ekonomiko-shoqërore dhe kulturore, Këto arritje dhe vijës së sjelljes nga viti në vit, nga një dekadë në tjetrën, nga shekulli në shekull, përcjellin vëmendje dhe dashuri, duke u bërë dritë për pasardhësit! Kjo si për sot dhe për nesër është thirrja mëse e kohës për të njohur dhe vlerësuar Vendlindjen, si dhe mos haruar kushtimin e të parëve për të dashur atdheun.

Çështja e parë *Të njohin edhe më mirë konceptualitetin për Atdheun

I.Konceptualitetin për Atdheun

Duaje atdheun, si shqipja follenë!

Atdheu është vendi ku kemi lindur e jetojmë ne dhe ku kanë jetuar të parët tanë. Vendi, ku banon prej kohësh një popull a një komb, mëmëdhe. Pra, vendi ku jeton dikush për një kohë të gjatë dhe e ndien veten si në vendin e vet. (fj. u.). Vendi ku lind e zhvillohet diçka për herë të parë, vendi prej nga buron a vjen diçka;).

a/1.Atdhetar

Ai që e do atdheun e popullin e vet dhe që u shërben atyre me besnikëri, ai që lufton me vetëmohim për të mbrojtur interesat e vendit të vet; që mbron me vetëmohim interesat e vendit të vet, duke qenë patriot; që shpreh dashuri për atdheun ose që frymëzohet nga dashuria për vendin e lindjes, që mbron me qëndrim patriotik.

a/2. Atdhetari

Dashuria për atdheun e për popullin e vet dhe gatishmëria për tu shërbyer atyre me besnikëri, ndjenja e detyrës për të mbrojtur me vetëmohim interesat e vendit e të popullit të vet, me patriotizëm.

Rilindasit u përpoqën shumë t'i bindnin shqiptarët se nuk duhet të turpëroheshin nga vendi i tyre. Atdheu i tyre ishte i bukur, gjuha e tyre ishte madhështore, ajo renditej në një prej 6 gjuhëve themelore të Evropës dhe një nga 10-12 gjuhët themelore të Botës. Shqiptarët ishin e janë racë e bukur trupërisht dhe tepër të aftë mendërisht, se kishin e kanë histori të shkëlqyer, dhe se gjëmat kombëtare nuk ishin një arsye për t'u ftohur me Atdheun, por përkundrazi, për tu afruar më fort rreth tij. Aksioni i tyre për zgjimin e Shqipërisë ishte më i madh dhe më i gjëri si një aksion kulturor në krejt historinë tonë shqiptare. Rrallë herë emërtimi i një lëvizje përkonte plotësisht me qëllimin e saj, ashtu si në rastin e Rilindjes Shqiptare. Në të vërtetë ishte Rilindja Kombëtare që Rilindi Shqipërinë, ishte ajo që lindi dhe që shtroi rrugën për Shqipërinë moderne

Atdheu - kjo fjalë e shenjtë e cila për çdo person ka kuptimin e vet të veçantë. Duke menduar për Atdheun, njerëzit kujtojnë vendin e mrekullueshëm dhe të madh në të cilin kanë lindur dhe janë rritur.

Çdo qytetar është i detyruar të njohë dhe respektojë vendin e tij. Mbi të gjitha, ai është një simbol i pavarësisë së shtetit dhe identitetit të tij. Edhe ata njerëz, të cilët, për arsye të ndryshme, janë të detyruar të komunikojnë në një gjuhë të huaj çdo ditë, përsëri duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën e tyre amtare dhe të mos e harrojnë atë. Gjithashtu e rëndësishme është njohja e historisë dhe kulturës së vendit të tyre nga ana e qytetarëve.

Dashuria për Atdheun është në zemrën e secilit prej nesh. Dashuria për Atdheun lind te ne gradualisht, madje edhe në fëmijëri na kapin përshtypjet e natyrës përreth nesh. Mbi të gjitha, gjithçka fillon me një fill të hollë bari, me një shpërndarje të luleve që pastrojnë gjithçka, që fillon dhe ecën me një vetëdije gjithë bindje për Atdheut tonë të bukur e plot dashuri. Çdo ditë mësonim e mësojmë diçka të re, ku merrnim e marrim frymë duke futur në qenien tonë ajrin e pastër si pjesë e botës sonë të vogël të quajtur “Mëmëdhe”.

Atdheu, para së gjithash, është vendi ku kemi lindur dhe kemi thënë fjalën e parë, nënë, baba, vendi ku kemi bërë miq të rinj dhe jemi miqësuar me ta, vendi me të cilin jemi lidhur me kujtime të mrekullueshme dhe të paharrueshme. Dashuria për Atdheun është e pastër dhe vetëmohuese. Ajo nuk nënkupton ndonjë fantazi, ajo është e ngjashme me dashurinë për nënën dhe familjen e saj. Ne nuk i zgjedhim prindërit, por i konsiderojmë ata si njerëzit më të mirë, më të dashur në të gjithë botën.

Thelbi i vërtetë i patriotizmit është- të jesh një bir besnik i vendit tënd, Atdheut tënd. Dashuria për Atdheun është pjesëmarrja në të tashmen dhe të ardhmen e saj, është gjithnjë në kërkim të mënyrave për të përmirësuar në vazhdimësi dashurinë për vendin ku ke lindur. Unë kam mendimin tim se, atdheu është një nga vlerat më të mëdha të jetës tonë. Ne kemi një vend ku kemi lindur, dhe për të është detyra jonë morale ta duam dhe ta mbrojmë atë në mënyrë që t'ua kalojmë atë pasardhësve tanë, së bashku me dashurinë për të.

Së pari; Mëmëdheu nuk është vetëm vendi ku keni lindur, por edhe pasuria shpirtërore e njerëzve: gjuha, kultura, mentaliteti, traditat dhe zakonet. Në çdo familje që janë të vetëdijshme për këto vlera, luhen këngë popullore, organizohen festa dhe në to mbretëron fryma kombëtare. Njerëzit përpiqen të njohin vendin e tyre, duke vizituar, e pikturuar jo vetëm vendet e bukura, por edhe çdo cep të tij.

Së dyti; edhe nëse një person jeton jashtë vendit, larg vendit në të cilin ka lindur dhe rritur me dashurinë për Atdheun...Ai, do të jetojë gjithmonë në zemrën e tij. Në vendet ku ka një diasporë të madhe të njerëzve tanë, njerëzit bashkohen për të mbështetur traditat e tyre amtare. Fatkeqësisht, sot ka shumë njerëz që e konsiderojnë veten patriotë, por nuk bëjnë asgjë për të përmirësuar jetën në vendin tonë. Patriotizmi nuk është thjesht dashuri për Atdheun, por edhe gatishmëri për tu ngritur në këmbë për të, për të sakrifikuar gjithçka për mirëqenien e popullit të tij.

Kështu, Mëmëdheu është dhurata më e vlefshme e popullit tonë. Më vjen mirë që kam lindur në atdheun më të shenjtë-Shqipëri një vend i veçantë (parë nga ana historike-Skënderbeu, Ismail Qemali, vëllezrit frashëri, e shenjtëruara nënë Tereza e mjaft të tjerë), krenohem për trimëritë në shekuj të shqiptarëve, që nuk lejuan shpërbërjen e trojeve, gjuhës, traditave, zakoneve-mikpritjes, besës, ndaj ndjej kënaqësi dhe dashuri pa kufi për atdheun, vendlindjen dhe mbarë kombin tonë. Atdheu qëndron mbi njerëzit që besojnë në të dhe e duan sinqerisht. Atdheu është kështjella që ne përpiqemi ta mbrojmë.

Ky është vendi që na tërheq, larg të cilit është e vështirë të jetohej. Mëmëdheu është një vend ku kthehem me gëzim dhe krenari. Dhe ndërsa ne jemi krenarë për Atdheun tonë, ai do të jetë shtëpia jonë. Konkretisht mendoj se, çdo qytetar duhet të njohë historinë, traditat e popullit të tij. Të duash dhe respektosh prindërit, të afërmit, njerëzit me nivel profesional, vlera intelektuale që i venë ato në shërbim të shoqërisë. Të bësh vepra të mira, të jesh aktiv në shërbim të shoqërisë duke ju referuar shtetit ligjor, shtetit demokratik, dhe mbrojtjes së lirive dhe drejtave të qytetarëve. Në këtë kontekst duhet ushtruar dhe angazhimi në mënyrë aktive për kujdesin sa më të mirë për natyrën. Nëse dikush nuk e kupton pse duhet ta dojë Atdheun, atëherë, tu shpjegohet thjesht atyre me sa shumë zell dhe me sa më shumë dashuri çështjen dhe vlerat atdhetare.

Poezi nga Naim Frashëri

ATDHEU

O Atdhe! Më je i dashur sa më s'ka
Më je nënë, më je motër, më je vlla.
Nga ç'ka rrotull më i shtrenjti ti më je,
Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhé.
Ty përditë të pat parë babai e nëna ime,
Dheu yt në fund atë e pati ngrënë.
Nëmëruar t'i pat lulet syri i saj.
Te ti lindi, te ti vdiq ajo pastaj.
Ti i ke parë gjysh stërgjyshërit e mi,
Edhe eshtërat tretur ua ke po ti.
Nga ti, o shpirt-o kurrë s'qenë ndarë.
Pranë teje patën qeshur, patën qarë.
Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë,
Nënë që s'ke vdekje kurrë, faqehënë,
Numri prapë në vend mbetet kurdoherë.
Begatoje, o Zot, ti këtë vend!
Epu njerëzve të tij ti mbroth e shend!
Hi u bëfshin gjithmon' armiqtë e tij!
Gas përjetë paçin zotërit e tij!
I begatë, i lulëzuar qoftë ai,
Një të ardhme pastë plot me lumturi!

Poezi nga Andon Z. Çajupi

MËMËDHEU

Mëmëdhe quhetë toka
ku më ka rënurë koka,
ku kam dashur mëm'e atë,
ku më njeh dhe gur' i thatë
ku kam pasurë shtëpinë,
ku kam njohur perëndinë,
stërgjyshët ku kanë qënë
dhe varret q'i kanë vënë,
ku jam rritur me thërrime
ku kam folur gjuhën time,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë,
ku rroj me gas e me shpres,
ku kam dëshirë të vdes.

Disa thënie Për Atdheun

Atdheu është vendi ku robërohet shpirti. Volteri
Dashuria për atdheun është mbi të gjitha dashuritë. Virgjili
Atdheu nuk mund të harrohet. Nuk ka sëmundje me fisnike se malli për atdheun. Haman
Atdheu nuk do dashuri të cunguar; ai që nuk bën gjithçka për të nuk bën asgjë; ai që nuk i jep
gjithcka atij, i ka mohuar gjithcka. Berne
Djaln që tradhton atdheun, nuk e do as nëna e vet. Naim Frashëri
Nuk ka këshillë më të keqe nga ajo që të shtyn të mohosh kombin tënd. N.Veqilharxhi

Një dimër në atdhe është më i ëmbël se njëqind pranvera në dhe të huaj. Greke
 Vetëm në vend të huaj njeh bukurinë e gjuhës amtare, vetëm atje ndjen ç'është mëmëdheu.
 Frajtag
 Atdheu është mbase, para se gjithash, gjuha. ~ Rozhe Marten dy Bukurosh
 Vendi i huaj nuk të behet atdhe. Gete
 Në atdhe njeriu ka edhe të kaluar edhe të ardhme. Në vend të huaj ka vetem të tashme.
 Hirshfeld
 Patriotizmi i vërtetë nuk është ai që mburret në castet solemne, por ai që cdo ditë e çdo orë
 kujdeset pa u lodhur për të mirën e pergjithshme dhe nuk arrin të mburret me këtë. Graf
 Që të jesh internacionalist duhet së pari të kesh një atdhe. Dyamel
 Mëmëdhenë e duam jo se është i madh, por sepse është i yni. Seneka i Riu.
 Në qoftë se arti nuk ka atdhe, artistët e kanë. Sen-San

Çështja e dytë * Përjetimi sa më qartazi i vendlindjes

II.VENDLIDJA

Vendlindja është vetëm një, si- NËNA.

Dashuria fillon në shtëpi: e para vjen familja, pastaj fshati apo qyteti yt.

Vendlidje-Vendi ku ka lindur dikush.!?

Kuptimin për vendlidjen për veç rilindsave tanë me mjaft koncizitet e marrim dhe te vepra e Rexhep Qoses-"Panteoni i Rralluar"

Vendlidja, në përmbajtjen e saj ka në thelb, sa dhe në mënyrë bazike: nënën, babanë, vëllezërit, motrat, shokët dhe shoqet e shkollës, mësuesit, lagjen, fshatim, qytezën apo qyteti, nëpër të cilët dalin me prindërit apo moshatarët. Më vonë, kur në pasqyrë të kërkojnë provën e personalitetit të vet, djali apo vajza, nipi apo mbesa do të mësojnë se bota është diçka më e madhe se **vendlindja** dhe me buzëqeshjen e habitës së tyre do të përkujtojnë naivitetin e miturisë së tyre. Me formimin e bindjeve etike, morale, ideologjike, politike dhe filozofike njeriu mëson, njëkohësisht, dhe kupton qartazi, se të gjithë njerëzit e gjakut dhe të gjuhës së tij i ka vëllezër e motra dhe arrin të bindet se ka arësye t'i dashurojë si Vendlidjen dhe Atdheun.

Vendlindja ime është vendi ku unë u lindi e u rrita, vendi ku mora mesimet e fëmijërisë, ku jetova çdo çast me gëzime dhe hidherimet e mia. Aty unë hodha hapin e parë dhe nisa rrugën e jetesës. Vendlindja është tokë e shenjtë, ku çdo pjesë e saj më kujton origjinën time. Tani jemi në një stinë (vjeshta), ku ajo nxjerr në pah çdo pjesë ose bukuri të vendit tim dhe kjo stinë po e zbukuron vendlidjen time. Tani vendlindja ime është veshur me një këmishëzë të gjelbër. Përveç luleve që kanë pushtuar çdo pjesë të vendlindjes time, freskia dhe flladi mbushin çdo hapësirë të çdo fshati, qyteze, qyteti, krahine e më gjerë. Malet kanë mungulluar dhe pastërëtia e malit është në maksimum. Me një fjalë çdo gjë është në rregull, sa dhe mahnitëse. Çdo pjesë e vendit tim është shumë e bukur. Ndaj duhet ta duam, ta dashurojmë, ta mbrojmë por edhe ta shijojmë sa më shumë.

Para se të shkruaja tekstin: "Vendlidja ime", "Korca dhe Devolli", kl.5-ta (Për Shtëpinë Botuese "ERIK"), bëra mjaft takime me mësues dhe nxënës, prindër, historian dhe ekspertë të kësaj fushe. Mora shumë motive që ta shkruaja me kujdes këtë teks. Kur i pyeta nxënësit: A ju flasim prindërit për dashurinë ndaj atdheut, vendlindjes, historisë së lavdishme të vendit e kombit tonë?", reagimet e tyre ishin befasuese ku lexohej çudia dhe habia duke u shprehur- "pse është e nevojshme që të njohim vendlidjen !?". Si ka mundësi, që asnjë nuk mendon se të edukosh një fëmijë, nuk do të thotë që t'i përballësh jetën e të rriturit me vështirësitë e hallet, papunësinë e korrupsionin, por duhet t'i mësosh gjërat kryesore që janë dashuria dhe respekti për familjen dhe vendlidjen, t'i mësosh rrënjët e tij, historinë për të ditur se kush është ai, nga vjen, jo thjesht si prejardhje e pemës gjenealogjike, por dhe mijëvjeçarët që ai ka në genet e tij.

Krenaria që ne shqiptarët dikur e kishim si virtyt, sot nga disa është kthyer në një mos përfillje dhe hundëpërpjetësi, një e metë që mund të përkthehet në çdo gjuhë të botës sot si një humbje e vlerave sa qytetare, kulturore, patriotike dhe social-shoqërore. Më herët kjo nuk ndodhte sepse krenaria e dikurshme ishte një ndjenjë e thellë dhe tepër e brendshme, kur shqiptari asgjë mund të mos kishte, por në sytë e tij lexohej krenaria e origjinës dhe e jetës që kishte bërë. Më kanë prekur thellë fjalët e një shqiptari (Koto Hoxhi), që luftoi në vitet e Lidhjes së Prizrenit për pavarësinë e vendit dhe u mbyll në ferrin e burgjeve turke.

Edhe në ato kushte të mjerueshme brenda në burg, ai qëndronte dhe mbahej me fjalët: *“Koka ime është në duart e Madhërisë; shpirti im i takon Perëndisë, mirëpo nderi është i imi!”* [marrë nga libri i jetës së Sevasti Qiriazit]. Njeriu rron për nder, për një fytyrë, për një emër. Të gjithë duhet tu mësojnë këtë gjë fëmijëve të tyre. Si mund të bëhet më i mirë ky vend, nëse ne nuk kemi mbjellë farën e duhur sot?! Nëse ne nuk i ushqejmë fëmijët tanë me gjëra të mira, si mund të mendojmë se vendlindja do të bëhet edhe më e mirë?!

Sa herë takoj prindër nxënësish (sidomos pasi bëra në disa shkolla 9-të vjeçare testin në kryqytet (Tiranë)- për të zbuluar dhuntitë dhe talentin e nxënësve që ishin me rezultate shumë të mira dhe të shkëlqyera), më pyesnin: e...si doli djali im apo vajza ime!? Unë përgjigjesha (nisur nga rezultati): Se kishte një fëmijë shumë i mirë, dhe mjaft kërkues e me sedër. Në këtë kontekst, më dukej më tepër e rëndësishme njeriu, pastaj nxënësi. Po ky njeri mund të bëhet akoma dhe më i mirë kur brumoset edhe me dashurinë për vendin, vendlindjen e tij.

Prandaj dhe them, që gjëja që më shumë duhet tu themi fëmijëve tanë, është dashuria për vendin, për atdheun, për kombin. Dhe pse këto fjalë sot na duken si fjalë që mezi thuhën, si fjalë e vjetër, si fjalë librash, mund t'i ç'pluhurosim e të kuptojmë shenjtërinë e tyre dhe të pranojmë se çdo gjë nis e vjen që aty. Një njeri pa rrënjë nuk jep fryte. Rrënjët ne i kemi në atdhe, në atë vend ku kemi lindur e jemi rritur. Në këtë kontekst cilësojmë se: Thelbi i historisë është se- nuk ka asgjë më të dashur për një person sesa vendlindja e tij. Historia gjithashtu, na mëson se jeta e dobishme për njerëzit përreth dhe për gjithë shoqërinë, na mëson dhe kujton se çdo person mund të promovojë dashurinë dhe përkushtimin e tij ndaj vendit të tij të lindjes i cili për këtë duhet të nderohet dhe respektohet në çdo ambient të trajtimeve historike dhe shoqërore.

Çështja e tretë* Ju sjell së afëmi të disa momente nga vendlindja ime, Korça

III- Vendlindja ime-Korça

Vendlindja ime është vendi ku jam gatuar dhe jam bërë ky që jam

Vendlindja, është fjala që më sjell menjëherë ndërmend vendbanimin tim të bukur Korçën. Vendi ku kam mësuar të flas dhe të hedh hapat e para drejt një të ardhmjeje të gjatë. Edhe nëse udhëtoj jashtë atdheut tim- malli për të nuk më venitët, madje ndodh e kundërta malli im për të sa vjen dhe rritet më shumë. Korça është shtëpia ime, është si një nënë e dytë për mua. Prandaj asnjëherë mos e harroni atdheun tuaj, dhe kurrë mos flisni keq për të.

Është emocion i veçantë të flasësh për vendlindjen tënde. Në çdo fjalë në çdo shkronjë për të më vijnë në mendje shumë kujtime...Bukuritë e qytetit të Korçës nuk janë pak, ato janë shumë sa nuk numurohen dot...Bukuritë e saj të bëjnë për vete dhe të nguliten në mendje për të mos i harruar asnjëherë...Dhe nëqoftëse ndodhesh larg ato të ftojnë që tu shkosh pranë.

Zona e Korçës e ndodhur në truallin historik të ilirëve dhe është banuar që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s.. Epoka e Bakrit zgjati nga mijëvjeçari i tretë deri në mijëvjeçarin e dytë p.e.s.

Deri në vitin 650 p.e.s. fushëgropa e Korçës udhëhiqej nga një dinasti e Mbretërisë ilire, ndërkohë pas vitit 650 u udhëhoq nga një dinasti Kaone. Gjatë kësaj periudhe zona banohej më së shumti nga fise Kaone dhe Molose.

photo: Bashkia Korçë



photo: Bashkia Korçë



Gërmimet arkeologjike rreth qytetit të Korçës kanë zbuluar një arkivol të shekullit II e.s. i cili tregon të gdhendur figurën e dy farkëtarëve ilirë duke punuar hekurin në kudhër. Vlen të përmendet Tuma e Kamenicës, fakt që tregon banimin e kësaj zone në epokën e bakrit. Rreth Korçës ndodhen qendra shumë të hershme si: Kamenica në komunën Mollaj të rrethit të Korçës, Podgoria, Maliqi dhe Devolli.

Korça përbën një nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë. Vetë muzeumet e shumta në qytet përshkruajnë aktivitetin kulturor ndër shekuj. Është e mirënjohur shkolla e parë shqipe në këtë qytet që daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917. Edhe pse ndër vite qyteti ka qënë pushtuar disa herë, ndikimet e huaja përbëjnë një pjesë të vogël të kulturës korçare.

Korça si qytet dhe rrethi i saj shquhen për objektet dhe mjediset e veçanta me vlera të larta turistike. Në Korçë ka fushë të gjerë veprimi turizmi kulturor, ekologjik, malor, etj. Në Korçë ndodhen Muzeu i Artit Mesjetar Shqiptar dhe Muzeu i Arsimit Kombëtar, Shtëpitë muze të piktorit me famë Vangjush Mio dhe atdhetarit të shquar Themistokli Gërmenji. Shkolla e vashave e të tjera.

Korçën e kanë quajtur: Qyteti i serenatave, Qyteti i dashurisë, Qyteti i Artit, Qyteti i birrës, Vendi i kërnackave, Parisi i Vogël, e po të kërkosh, gjen plot epitete të tjera që cilësojnë vlerat e saj por edhe karakteristikat se përse duhet vizituar një qytet si Korça.

E hapur qysh herët me botën, drejt perëndimit (shumë korçarë emigruan herët në Amerikë, por edhe shumë atdhetarë e intelektualë më herët, në Turiqi e Ballkan), Korça është një qytet i qeshur e plot jetë, që të fton në çdo stinë të vizitosh rrugët e saj karakteristike, të mësosh për kulturën dhe historinë e saj, të kuptosh pse shumë atdhetarë që sot mbushin faqet e historisë së kombit, ishin pikërisht nga Korça. Por edhe për të pirë një birrë me “kërnacka”, do të ndjesh po aq kënaqësi e mikpritje, sepse kudo që të shkosh nëpër qytet e në të gjitha fshatrat e tij, gjëja e parë me të cilën do të takohesh, është pikërisht mikpritja e korçarëve.

Ekoturizmi është një fushë me interes të veçantë për të apasionuarit e natyrës së bukur korçare. Ky është një qytet gazmor e magjik, që me serenatat e tij është bërë i njohur në të gjithë botën. Në qytetin e bukur të Korçës kam kaluar një fëmijëri mjaft mbreslënëse, aty hodha hapat e para, mbarova shkollën nga- klasa e parë deri te klasa e 12-të e shkollës së mesme.

Është një qytet i rrethuar nga male të gjelbëruar. Mali i “Moravës”, i jep një bukuri të rrallë, gjithë freski dhe pastërti. Vendlindja ime Korça ka tradita dhe zakone të veçanta, rrugë të shtruara me kalldrëm dhe shtëpi të rrethuara me kangjella. Djemtë këndojnë serenata të bukura, vajzave që i ndjekin nga ballkonet gjithë kënaqësi. Korça për çdo stinë shfaq bukuritë e saj. Stina e pranverës e bën Korçën të duket si një mrekulli e vërtetë ku të gjitha pemët, lulet lulëzojnë dhe gjelberimi vesh qytetin si një nuse e re..e ngado ndjehet dhe shijohet era e këndëshme e luleve....ky ambient i këndshëm i bën qytetarët të buzëqeshur dhe të gëzuar.



Stina e dimrit sado e acarte të jetë Korçën e vesh hijshëm si një nuse me fustan të bardhë. Korçarët, e shijojnë këtë stinë të shëndetëshme, duke bërë xhiro mbasdite, bulevardit kryesor, por edhe duke vozitur nëpër rugicat në parkun “Rinia”.

Për mua Korça është djepi i arsimit, kulturës, qytetërimit, bukurisë, serenatave dhe mikpritjes. Është pika ku unë nisa gjithë këtë rrugëtim aspak të lehtë. Sa do kohë të kalojë Korça do të ketë një vend special në zemrën time.



4.*Përmbledhje, Rekomandime

A. Përmbledhje:

Vendlindja ime është vendi ku jam gatuar dhe më ka bërë ky që jam. Ajo është drita e shpresës që ndriçon në tunelin e errët të frikës, urrejtjeve, dhe ndasive. Atdheu është vendi ku jemi takuar me shoqet-shokët tanë në jetë. Na ka mësuar se çfarë është natyra, jeta, familja dhe edukata dhe brumos karakterin tonë. Në vendlindje ndodhen rrenjët e të parëve tanë. Kështu që nëse dikush mundohet ta mohojë atdheun, e ka të kotë ai veç e zhvlerëson veten. Atdheu na ka bërë këta që jemi. Ndoshta për disa (të paktë në numër), dhe sidomos për disa të rinjë, atdheu dhe lidhjet që kemi ne me të mund të duket një koncept i vjetëruar.

Por, unë ju them se ju nuk e keni idenë se sa e fortë, sa emocionuse dhe sa ndjenja krenarie të jep lidhja me vendlindjen. Nuk e merrni dot me mend se ai që do vendlindjen, atdheun, kombin, gjuhën, zakonet, traditat, kur ndodhet larg se sa shumë do të digjte nga malli për vendlindjen. Një atdhetar, shpirtin dhe zemrën e ka atje, tek malet, fushat, lumenjtë, pyjet, këngët dhe vallet. Kështu ka ndodhur e ndodh me shumë emigrantë që kanë ardhur në atdhe. Pra, kjo është ajo që e bën atdheun, kombin, vendlindjen kaq të vecantë. Në mënyrë që vendi të lulëzojë, është e nevojshme të kryhet një punë sistematike për të futur në brezin në rritje një

ndjenjë të patriotizmit. Ndjenja e dashurisë për vendlindjen është një cilësi që duhet të rritet, duke filluar punën sistematike nga një moshë parashkollore më e re.

Dashuria për Atdheun, lind që nga fëmijëria e hershme. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje edukimit mjedisor në institucionet parashkollore. Gjatë shëtitjeve, mësuesi duhet t'ju tregojnë fëmijëve se si të ndihmojnë ecurinë e jetës së tyre veç të tjerave dhe për të njohur historinë e vendit dhe vendlindjeve të tyre, sikurse dhe për t'ju kultivuar dashurinë për- prindërit, të afërmit, shoqërinë, edukatorët tje, por dhe duke ju kultivuar, qëndrimin dhe dashurinë ndaj luleve, pemëve e deri te shkurret, në këtë mënyrë ndodh realisht dhe natyrshëm që të lindë dashuria e vërtetë për atdheun e tyre të vogël.

B. Rekomandime

Dashuria për Atdhe duhet të kultivohet gjithmonë dhe s' është e mjaftueshme asnjëherë. Nderimi i sotëm dhe dashuria për të është nderim për të kaluarën, për familjen, për gjithë ata që ranë për lirinë e vendit. Ne krenohemi me vendin që për herë të parë na panë sytë në këtë jetë, me tokën në të cilën mbështetëm kokën dhe shtrimë, trupin, në vendin e stërgjyshërve e baballarëve tanë. Por, dashuria për atdheun duhet të jetë më e madhe se etja për fitim, duhet të jetë më e madhe se ambiciet personale, apo interesat e ulëta individuale. Nuk duhet të pyesim se çdo të bëjë atdheu për ne, por se çfarë ne do të bëjmë për të?

Ndjenja e dashurisë për vendlindjen është një cilësi që duhet të rritet, duke filluar punën sistematike nga një moshë parashkollorepra më e re. Brezi ynë duhet që të ketë më shumë respekt dhe të vlerësojë në maksimum kontributin e rilindasve dhe të parëve tanë. Nëse ne jemi shqiptarë që flasim shqip dhe kemi një flamur kuq e zi, kjo është falë tyre. Në ditët e sotme, shqiptarët jetojnë të ndarë dhe të shpërndarë. Unë e konsideroj fyerje antikombëtare që të krijojmë diferencime mes shqiptarësh. Qoftë, ortodoksë, katolikë, myslimanë, të gjithëve gjak shqiptari ju rrjedh.

Sot, Shqipëria është një shtet që po e lodh trazicioni i gjatë nga ana ekonomike, shoqërore me problematika të mëdha, për aq sa i përket ritmeve të rritjes së mirqënies dhe stabilizimit ekonomik. Në këtë kontekst, që të gjithë neve intelektualve, mësime dhënëse na del për detyrë, që të kontribuojmë që Shqipëria dhe kudo që jetojnë shqiptarët si bashkëkombas, të jetë një vend edhe më i mirë, që shqiptarët të jenë më të lumtur dhe në harmoni të plotë. Duke punuar fort për të ardhmen e kombit. Duke i sjellë prosperitet në vazhdim. Dhe duke ushqyer brezat që do vijjnë me ndjenjën e atdhedashurisë dhe të patriotizmit.

Çdo qytetar është i detyruar të njohë dhe respektojë vendin e tij. Mbi të gjitha, ai është një simbol i pavarësisë së shtetit, identitetit të tij. Edhe ata njerëz, të cilët, për arsye të ndryshme, janë të detyruar të komunikojnë në një gjuhë të huaj çdo ditë, përsëri duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën e tyre amtare dhe të mos e harrojnë atë. Është gjithashtu e rëndësishme të njihni historinë dhe kulturën e vendit tuaj. Unë ju këshilloj që ta duani dhe kontriboni për atdheun dhe vendlindjen tuaj, kurrë mos e shani dhe t'i ktheni shpinën. Për atdheun mund të shkruash gjithë jetën tënde, por përsëri kjo do të ishte pak. Nuk mjafton vetëm ta duash atë, por edhe të punosh e luftosh për të.

Referencat

- [1]. Tekst shkollor për klasat e 5-ta "*Vendlindja ime Korça dhe Devolli*", Dr.I.S.Larti, Nedai Thëllimi Shtëpia Botuese "Erik", Tiranë 2008.
- [2]. Monografi 100 vjet Pavarësi – Flamuri që Ringjalli një Komb libër me Autorë Moikom Zeqo dhe Dëshira Jazexhiu. Shtëpisë Botuese "Erik" . Tiranë, 2012
- [3]. *Atdheu* (Botuar nga: Fjala Publishing në 2019 Autori: Fernando Aramburo) Përkthyesi: Bashkim Shehu
- [4]. *E dhanë jetën për atdhe* (Botuar nga: Raka në 2017) Autori: Qirjako Dhima
- [5]. Monografia, *Edhe zogjtë e duan atdheun*, e Islam Vanit
- [6]. *Flas me Atdheun* Autore Zarije Zenuni Bajrami me link <https://panairionline.com/oferteporosia.asp>